

VENDIM
Nr.224, datë 19.4.2006

PËR CAKTIMIN E NIVELIT BAZË TË SË ARDHURËS NGA PAPUNËSIA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 54, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Niveli bazë i së ardhurës nga papunësia të jetë 5240 (pesë mijë e dyqind e dyzet) lekë në muaj.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2006, grupi 25, titulli 065, kap. 1, art 604 “E ardhura nga papunësia”, miratuar për Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

3. Vendimi nr.583, datë 10.9.2004 i Këshillit të Ministrave “Për caktimin e nivelit bazë të së ardhurës nga papunësia”, shfuqizohet.

4. Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Shërbimi Kombëtar i Punësimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.5.2005.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha